



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



Në mbështetje të paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të nenit 87 dhe nenit 91 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP nxjerrë këtë:


INTERPRETIM

Me qëllim që platforma për prokurimin publik të mos stërngarkohet me dokumente, si dhe duke pas parasysh se Dosja e Tenderit është vetëm një dokument i cili u shërben Operatorëve Ekonomik për me përgatitë ofertën, atëherë **Dosja e tenderit nuk duhet të ngarkohet në platformë nga OE me rastin e dërgimit të ofertës.**

Në përputhje me nenin 69 të këtij ligji lidhur me **aftësitë teknike dhe profesionale**, AK-të në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë mund të kërkojnë "*Listën e kontratave të realizuara në periudhën e shkuar trivjeqare...*" varësisht nga lloji i kontratës furnizim, shërbime apo punë, si dhe cilëndo dëshmi tjetër të përcaktuar me këtë nen. Në asnjë mënyrë nuk duhet kërkuar kopejt e kontratave si dëshmi. Në çdo rast, AK-ja mund të verifikojë cilën do referencë nga lista e kontratave nëse e gjykon të arsyeshme.

Si rrjedhojë, **Kopjet e kontratave nuk duhet të ngarkohen në platformë nga OE me rastin e dërgimit të ofertës.**

Dt. 05/04/2017


Safet Hoxha – Kryetar i KRPP-së